



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Nr. 1295/4 Prot.

Vlorë më, 29.4.2025

VENDIM PROPOZUES

Nr. 53, datë 29.04.2025

**PËR
PËR MIRATIMIN E PAGESËS PËR ANËTARËT E KËSHILLIT TË ETIKËS NË
UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE**

Në mbështetje të nenit 44, të Ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 28 të Statutit të Universitetit "*Ismail Qemali*", Vlorë, Senati Akademik, duke marrë parasysh ngarkesën psikologjike të anëtarëve, presionin në punë, mungesën e interesit nga ana e stafit akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe studentëve gjatë çeljes së procesit zgjedhor për anëtarë të Këshillit të Etikës si dhe me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes dhe motivimin e tyre, në mbledhjen e tij të datës 29.04.2025

VENDOSI:

1. T'i propozojë Bordit të Administrimit miratimin e shpërblimit mujor për anëtarët e Këshillit të Etikës, për një periudhë 10-mujore gjatë vitit akademik, duke përjashtuar muajt e pushimeve vjetore (korrik dhe gusht).
2. Kjo pagesë të kryhet në përputhje me ngarkesën dhe përgjegjësitë që burojnë nga funksioni i tyre.
3. Shpërblimi do të jepet vetëm nëse Këshilli i Etikës zhvillon minimalisht një mbledhje në muaj. Mbledhjet duhet të jenë të dokumentuara me procesverbale përkatëse.
4. Masa e shpërblimit propozohet të jetë 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj për secilin anëtar të Këshillit të Etikës.
5. Pagesa të kryhet në përputhje me buxhetin e miratuar dhe procedurat financiare në fuqi.
6. Vendimi i percillet për shqyrtim dhe miratim Bordit të Administrimit.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR. AURELA SALIAJ